



Përmbledhje e Aktivitetit të Misionit të RSH-së në Këshillin e Sigurimit (Java 1)

1 - 7 janar 2022

1 janar 2022

- Me fillimin e vitit 2022, Shqipëria nisi mandatin e saj historik si anëtare e tryezës më të rëndësishme në botë, atë të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Në kuadër të planit të komunikimit ky moment u pasqyrua gjerësisht në mediat sociale duke vënë në pah vecanërisht se Shqipëria është e vendosur të luajë një rol aktiv dhe konstruktiv, të jetë e hapur dhe transparente dhe do të përcjellë vlerat e saj në punën e Këshillit.

4 janar 2022

- Sipas traditës për vendet anëtare të zgjedhura, për herë të parë, flamuri shqiptar u vendos në këndin ku "dritat nuk fiken kurrë" – në hyrje të sallës së Këshillit të Sigurimit – përkrah 14 flamujve të tjerë të vendeve të tjerë të KS.
- Që në muajin e parë të pranisë në Këshill, Shqipëria mori rolin e koordinatorit për muajin janar të vendeve të zgjedhura (E10 - elected 10). Kjo e angazhon vendin tonë të organizojë takime specifike sipas traditës, të jetë ndërmjetës e lehtësues për çështje që kanë nevojë për trajtimit të vecantë e zgjidhje mes vendeve të zgjedhura.

5 janar 2022

- Mbledhja e Këshillit të Sigurimit për Sirinë, Armët Kimike, Shqipëria theksoi mungesën e bashkëpunimit nga Siria dhe u kërkoi autoriteteve të bashkëpunojnë plotësisht me OPCW në përputhje me Rezolutën e KS 2118.

6 Janar 2022

- Në këtë kuadër, Misioni organizoi me drekën tradicionale të Ambasadorëve të E10 me Sekretarin e Përgjithëm Guterres, një format diskutimi informal, i nivelit më të lartë të Organizatës me vendet e zgjedhura të Këshillit. Dreka u përqendrua në diskutimin e dy çështjeve akutë: situatë dhe problematikat aktuale në Afganistanin si dhe situatë dhe problematikat në Liban, pas vizitës së SP atje.

- Gjatë javës së shkuar Misioni ka qenë vecanërisht I angazhuar, në cilësi të dyfishtë (edhe si vend i interesuar edhe në kapacitetin e koordinatorit të E10) lidhur me negociatat që janë në vazhdim për të finalizuar ndarjen e kryesimit të Organeve Ndihmëse të Këshillit të Sigurimit. Në përputhje me angazhimin por për të qenë sa më aktiv në ushtrimin e mandatit, Shqipëria pritet të kryesoje 4 komitete: ato për Libanin, Irakun, Jemein si dhe synon të marrë kryesinë e grupit të punës mbi Metodën e Punës së Këshillit të Sigurimit. Lidhur me këtë të fundit, prej muajsh diskutimet janë të bllokuara nga pozicionimi kryenec i Brazilit, i cili gjithashtu kërkon kryesimin e këtij Grupi Pune. Të gjitha vendet e Këshillit kanë vlerësuar lart pozicionimin bashkëpunues të Shqipërisë, ofertat që i janë bërë Brazilit për bashkëpunim në këtë kuadër e të cilat nuk janë pranuar. Në këtë dosje, Shqipëria gëzon mbështetjen e të 5 vendeve të Përhershme (P5).
- Misioni Shqiptar pranë OKB-së, mori pjesë në një aktivitet të organizuar nga Suedia, me praninë e Ministres së Jashtme Suedeze, me temë "Politika e Jashtme Feministe +" Shqipëria do të promovojë një qasje feministe për zbatimin e Agjendës së Përbashkët dhe atë të Grave, Paqes dhe Sigurisë, si një nga prioritetet kryesore si anëtare e Këshilli i Sigurimit për 2 vitet e ardhshme. Takimi radhës mendohet të mbahet në Mars dhe të ishte mirë që vendi ynë të bëhej zyrtarisht pjesë e grupit që kanë një Politikë të Jashtme feministe.
- Britania e Madhe e ftoi vendin tonë t'i bashkohet grupit të vendeve të Këshillit që kërkojnë të mbahen konsultime ose të ngrihet në pikën AOB (Çështje të Tjera) situata në Sudan, parashikuar për me datë 13 janar 2022. Vendi ynë iu bashkua kërkesës së bashku me Francën, Irlandën, SHBA dhe Norvegjinë.
- SHBA e ftoi vendin tonë që ti bashkëkohej kërkesës për të mbajtur konsultime të mbyllura për të dënuar lëshimin e raketës ballistike nga Koreja e Veriut. Vendi ynë ju bashkoi thirrjes së bashku me Britaninë e Madhe, Irlandën dhe Francën. Takimi u mbajt në datën 10 janar 2022, si dhe kërkesës për dalje publike para takimit.

#